



Janar 2019

EKONOMIA DHE BUXHETI

Raport Mujor

Shkurt

Mars

Prill

Maj

Qershor

Korrik

Gusht

Shtator

Tetor

Nentor

Janar

EKONOMIA DHE BUXHETI

Raport Mujor

Janar 2019

© Ministria e Financave, 2019

Drejtoria e Makroekonomisë dhe Statistikave
Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”, Nr. 3, Tiranë

www.financa.gov.al

E-mail: vivi.besho@financa.gov.al

Përmbajtja

VEÇORITË KRYESORE	2
ZHVILLIMET EKONOMIKE	3
1. Indeksi i Çmimeve të Konsumit	3
2. Kursi Mesatar i Këmbimit	4
3. Ecuria e Normave të Interesit të Depozitave dhe Huave	5
4. Bilanci i Pagesave	6
5. Mjetet Valutore Neto të Sistemit Bankar	7
6. Kredia për Ekonominë	8
7. Oferta e Parasë	9
8. Depozitat sipas Burimeve	10
SEKTORI FISKAL	11
1. Buxheti i Konsoliduar	11
2. Të Ardhurat sipas Burimeve	12
3. Financimi i Bilancit Fiskal	12
ANEKSI STATISTIKOR	13

Veçoritë Kryesore

- *Indeksi i çmimeve të konsumit në muajin Janar 2019 arriti në 107.6 për qind;*
- *Norma vjetore e inflacionit për muajin Janar 2019 ishte 1.9 për qind;*
- *Kursi mesatar i këmbimit të monedhës vendase me dy monedhat kryesore të huaja për muajin Janar 2019 ishte 108.92 lekë për dollarë dhe 124.39 lekë për euro;*
- *Normat e interesit të depozitave në lekë gjatë muajit Janar 2019 shënuan kuotën 0.73 për qind për ato 12 –mujore; 0.45 për qind për depozitat 6-mujore; 0.24 për qind për depozitat 3-mujore dhe 0.65 për qind për depozitat 1-mujore;*
- *Normat e interesit për huatë në lekë ishin 6.7 për qind për huatë 12-mujore dhe 7.6 për ato 6-mujore;*
- *Oferta totale e parasë, e matur nga agregati M3, arriti në rreth 1.274.889 milionë lekë në muajin Janar, duke shënuar një rritje prej rreth 1.3 për qind, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë;*
- *Bilanci i përgjithshëm i pagesave për tremujorin e tretë të 2019-ës shënoi rritje të mjeteve valutore (rezervës), duke shënuar vlerën 154.8 milionë euro.*
- *Situata Buxhetore për periudhën Janar 2019 rezultoi me një deficit të përgjithshëm prej rreth 2.1 miliardë lekë, ndërkohë që ishte planifikuar deficit prej 2.4 miliardë lekë.*
- *Të ardhurat gjithsej të realizuara gjatë periudhës Janar 2019, arritën në rreth 34.532 miliardë lekë ose afërsisht 98% e planit për këtë periudhë.*
- *Shpenzimet gjithsej gjatë të njëjtës periudhë, arritën në rreth 32.422 miliardë lekë ose 99% e shpenzimeve të planifikuara për këtë periudhë.*

Zhvillimet Ekonomike


1. Indeksi i Çmimeve të Konsumit

Inflacioni vjetor për muajin Janar 2019 ishte +1.9%. Ndërsa, një vit më parë ndryshimi vjetor i indeksit të çmimeve të konsumit ishte +1.7%.

Indeksi i Çmimeve të Konsumit (IÇK) për muajin Janar 2019 shënoi rritje prej 1.6 për qind krahasuar me muajin paraardhës, gjithashtu në muajin Dhjetor 2018 pati rritje prej 1.1 për qind. Përgjatë muajit Nentor 2018, indeksi ka shënuar rënie prej 0.2 për qind në krahasim me muajin paraardhës përkatës. Përsa i përket një viti më parë, Indeksi i Çmimeve të Konsumit për muajin Janar 2018 shënoi rritje prej 1.5 për qind në krahasim me muajin paraardhës.

Krahasuar me muajin Janar 2018, rritja më e madhe e çmimeve vërehet në grupin “Ushqime dhe pije joalkoolike” me 4.3%, pasuar nga grupet “Argëtim dhe kulturë” dhe “Pije alkoolike dhe duhan” me 1.8% secila, “Hotele, kafene dhe restorante” me 1.1%, “Qira, ujë, lëndë djegëse dhe energji” me 0.8%, “Shërbimi arsimor” me 0.7%, “Komunikimi” me 0.4%, etj.

Nga tërësia e mallrave dhe shërbimeve që përbëjnë shportën e konsumit, kategoritë “Veshje dhe këpucë” dhe “Shëndeti”, kanë



ndikuar negativisht në inflacionin e përgjithshëm përgjatë muajit Janar 2019.

Ndryshimi mujor i indeksit është 1.6%. Krahasuar me muajin Dhjetor 2018, çmimet e grupit “Ushqime dhe pije joalkoolike” u rritën me 4.6%, pasuar nga grupet “Pije alkoolike dhe duhan” me 0.3%, “Veshje dhe kepuce” me 0.2% etj. Ndërsa, çmimet e grupit “Transporti” u ulën me 1.4%, “Argëtim dhe kulturë” me 0.6 % etj .

Tab - 1 *Ndryshimi vjetor i Indeksit të Çmimeve të Konsumit (në %)*

VITI	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor
2018	1.7	2.1	2.0	2.1	2.1	2.4	2.3	2.2	2.1	1.9	1.8	1.8
2019	1.9											

Burimi: INSTAT


2. Kursi mesatar i këmbimit

Kursi mesatar i këmbimit të lekut kundrejt euros në muajin Janar 2019, arriti në 124.39 lekë/euro, duke shënuar rritje në vlerë me 0.76 për qind krahasuar me një muaj më parë. Në fund të muajit Janar, një euro u këmbye me 124.64 lekë.

Kursi mesatar i këmbimit të lekut kundrejt dollarit amerikan në muajin Janar 2019 arriti në 108.92 lekë/dollarë duke shënuar rritje në vlerë me 0.46 për qind kundrejt muajit Dhjetor 2018. Në fund të muajit Janar, kursi i këmbimit për dollarin amerikan arriti në nivelin 108.58 lekë/dollarë.

Në krahasim me muajin Janar të vitit të kaluar, rezulton se monedha shqiptare është mbiçmuar (mesatarisht) ndaj monedhës evropiane në masën 6.87 për qind, ndërsa kundrejt dollarit amerikan rezulton se është mbiçmuar në masën 0.55 për qind. Forcimi i lekut në dy vitet e fundit është nxitur nga përshpejtimi relativ i rritjes ekonomike në vend, pritjet për vazhdimin e kësaj tendence në të ardhmen dhe reduktimi i primit të rrezikut për ekonominë tonë.

Fig-2



Ecuria e Kursit të Këmbimit gjatë muajit Janar 2019

Burimi: Banka e Shqipërisë

Kursi i këmbimit të euros me dollarin amerikan, pësoi një rritje mesatare rreth 0.88 dollarë/euro. Ndër faktorët e brendshëm që kanë ndikuar në ecurinë e monedhës vendase gjatë këtij muaji përmendim: ruajtja e ritmeve pozitive të rritjes ekonomike në vend, efikasiteti i politikës fiskale, efikasitet në politikën monetare dhe në operacionet ndërbankare të ndërmarra nga Banka e Shqipërisë, etj.


3. Ecuria e Normave të Interesit të Depozitave dhe Huave

Gjatë muajit Janar 2019, normat e interesit të depozitave me afat 12 dhe 1 mujore shënuan vlerat më të larta prej 0.73 dhe 0.65 për qind, pasuar nga ato me afat 6 dhe 3-mujore që arritën përkatësisht kuotën 0.45 dhe 0.24 për qind.

Normat e interesit të depozitave 1 mujore kanë shënuar rritje mujore prej 0.03 pikë përqindje, ndërsa normat e interesit të depozitave 12, 6, dhe 3 mujore kanë pësuar rënie prej përkatësisht 0.02, 0.11 dhe 0.06 pikë përqindje.

Krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë, normat e interesit të depozitave me afat maturimi 6, 3 dhe 1 mujore, kanë pësuar rënie prej përkatësisht 0.24, 0.04 dhe 0.27 pikë përqindje, ndërsa ato me afat maturimi 12 mujore kanë pësuar rritje me 0.01 pikë përqindje.

Fig. 3




Normat e interesit për depozitat (%)

Burimi: Banka e Shqipërisë

Normat e Interesit të huave 6 dhe 12-mujore gjatë muajit Janar 2019 arritën përkatësisht kuotën prej 7.63 dhe 6.76 për qind. Normat e interesit të huave 12-mujore kanë shënuar rritje mujore prej 0.42, ndërsa normat e interesit 6-mujore kanë pësuar rënie me 0.53 përqind. Duke krahasuar me një vit më parë normat e interesit të huave 12 dhe 6-mujore kanë shënuar përkatësisht rritje prej 0.11 dhe rënie 2.51 pikë përqindje.

Normat e interesit të bonove të thesarit 12 mujore gjatë muajit Janar 2019 arritën nivelin 1.33 për qind duke shënuar kështu rënie mujore prej 0.10 për qind dhe rënie vjetore prej 1.38 për qind.

Fig-4



Normat e interesit për huatë dhe bonot



Burimi: Banka e Shqipërisë

4. Bilanci i Pagesave

Bilanci i përgjithshëm i pagesave për tremujorin e tretë të vitit 2018 shënoi rritje të mjeteve valutore, me rreth 154.8 milionë euro. Tremujori i tretë i 2018-ës u mbyll me një deficit të llogarisë korrente prej rreth 146 milionë euro, dhe vlerësohet lehtësisht në terma vjetore (rreth 3%). Deficiti tregtar u ngushtua me rreth 3%, në nivelin 361 milionë euro. Shkalla e ekspozimit të ekonomisë shqiptare vlerësohet në 124 milionë euro në rënie me 11 milionë euro krahasuar me një vit më parë. Flukset e kapitalit, shumat e tepricave nën zërin “Llogaria kapitale” dhe “Llogaria financiare”, regjistruan një pozicion prej rreth -142.8 milionë euro. Karakteristika strukturore e Bilancit të Pagesave paraqitet në figurën 5.

Gjatë periudhës transaksionet në llogarinë korrente vlerësohen rreth 3.324 milionë euro dhe janë zgjeruar me 9% në terma vjetorë. Deficiti i llogarisë korrente shënon 146 milionë euro, në rritje vjetore me rreth 3%. Ecuria e deficitit korrent në këtë tremujor, reflekton balancën negative të të ardhurave parësore, ndërkohë që, vijon axhustimi deficitit tregtar në mallra. Në të njëjtën kohë, suficiti i të ardhurave dytësore është zgjeruar në drejtim të rritjes së transfertave hyrëse drejt sektorëve të tjerë. Kompozicioni i deficitit të llogarisë korrente shprehet sipas elementeve kryesorë përbërës (në terma neto) për tremujorin e tretë 2018 (Fig-6):


- (i) bilanci tregtar me -740.6 milionë euro,
- (ii) shërbime neto me 379.9 milionë euro,
- (iii) të ardhura neto me -18.5 milionë euro,
- (iv) transferta neto me 232.7 milionë euro.



5. Mjetet Valutore Neto të Sistemit Bankar


Gjatë muajit Janar 2019, sistemi bankar ka shënuar rritje të mjeteve valutore neto (M.V.N), me rreth 31.304 milionë lekë krahasuar me muajin Janar të vitit 2018. Kjo rritje ka ardhur kryesisht si pasojë e rritjes së mjeteve valutore neto bankës qendrore me rreth 30.239 milionë lekë.

Krahasuar me një muaj më parë mjetet valutore neto kanë shënuar rritje me 8.371 milionë lekë, ku më së shumti ka kontribuar rritja mujore prej 16.658 milionë lekë të bankave paradepozituese.



Oferta totale e parasë, e matur nga agregati M3, arriti në 1.274.889 milionë lekë në muajin Janar 2019, duke shënuar rritje prej rreth 15.798 milionë lekë krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë, pra një rritje vjetore prej 1.3 përqind.

Në muajin Janar 2019, sistemi bankar rezulton me rritje prej 10.960 milionë lekë ose 0.9 përqind në mjetet valutore neto krahasuar me muajin paraardhës.





6. Kredia për Ekonominë

Totali i kredisë për ekonominë për muajin Janar 2019 arriti në rreth 536.695 milionë lekë. Balanci i kredisë, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë, shënoi rënie me vlerë 14.100 milionë lekë, ose rënie prej rreth 2.56 për qind. Struktura e kredisë sipas monedhave është e balancuar mes monedhës kombëtare (50.1%) dhe monedhave të huaja (49.9%).

Gjatë muajit Janar 2019, zëri “Korporata të tjera jo-financiare”, zuri peshën më të lartë të kredive, me rreth 59.7 për qind ose 320.223 milionë lekë, ndjekur nga kreditë për individë, ku pesha e tyre specifike arriti në nivelin 34.42 për qind ose 184.751 milionë lekë. Zërat “Korporata jofinanciare publike” dhe “Korporata të tjera financiare” arritën respektivisht 3.88 dhe 1.91 për qind apo 20.811 dhe 10.234 milionë lekë.


Për sa i përket shpërndarjes së kredisë sipas monedhës për muajin Janar 2019, zëri “Korporata të tjera jofinanciare” zuri peshën më të lartë të kredive në lekë, me rreth 72.0 për qind, ndjekur nga “Sektorë të tjerë rezidentë” me rreth 24.2 për qind. “Korporata të tjera financiare” dhe “Korporata jofinanciare publike” kontribuojnë përkatësisht me rreth 1.5 për qind dhe rreth 2.05 për qind.



7. Oferta e Parasë

Paraja jashtë Korporatave Depozituese arriti në rreth 271.542 milionë lekë në fund të muajit Janar 2019. Raporti i Parasë jashtë Bankave me M3 në Janar 2019 ka shënuar ulje mujore prej 0.48 për qind si dhe rritje vjetore prej 0.86 për qind, dukë arritur nivelin 21.3 për qind. Raporti i Parasë jashtë Bankave me Depozitat ka shënuar gjithashtu rënie mujore prej 0.78 për qind dhe rritje vjetore prej 1.37 për qind, duke shënuar nivelin 27.1 për qind.


Fig-11



Raporte të parasë jashtë bankave me M3 dhe Depozitat
Burimi: Banka e Shqipërisë

Depozitat në valutë, si përbërësi kryesor i ofertës monetare për muajin Janar 2019, kanë pësuar rritje prej 9.213 milionë lekë, e sjellë kryesisht nga depozitat për individë, të cilat kanë përbërë rreth 80.6 për qind të depozitave në valutë. Ndërsa depozitat në Lekë gjatë muajit Janar 2019 shënuan rënie prej 7.558 milionë lekë në krahasim me muajin Janar 2018. Sektori i Individëve në lekë ka zënë rreth 82.1 për qind të tyre.

Fig-12




Raporti i Depozitave ndaj M3
Burimi: Banka e Shqipërisë

8. Depozitat sipas Burimeve

Gjatë muajit Janar 2019, zëri “Sektorë të tjerë rezidentë” zuri nivelin më të lartë të depozitave të transferueshme në lekë, me rreth 82.1 për qind, ndjekur nga “Korporata të tjera jofinanciare”, me rreth 13.6 për qind dhe nga “Korporata jo-financiare publike” me 2.5 për qind. “Sektorë të tjerë rezidentë” dhe “Korporata të tjera jofinanciare” ishin gjithashtu burimi më i rëndësishëm i depozitave në monedhë të huaj, përkatësisht me rreth 80.6 për qind dhe rreth 17.2 për qind. “Sektorë të tjerë rezidentë” ishin dukshëm burimi më i rëndësishëm i depozitave totale me rreth 81.3 për qind e totalit.

Fig-13




Rritja e stokut total të depozitave

Burimi: Banka e Shqipërisë

Në total, “Sektorë të tjerë rezidentë” përbëjnë pjesën më të madhe me rreth 815.713 milionë lekë të depozitave totale. Ata ndiqen nga “Korporata të tjera jofinanciare” (156.010 milionë lekë), “Korporata të tjera financiare” (15.091 milionë lekë), dhe “Korporata jofinanciare publike” (15.076 milionë lekë). “Qeveria lokale” kontribuoi me rreth (1.455 milionë lekë) në totalin e depozitave.

Fig-14



Përberja e depozitave Janar 2019

Burimi: Banka e Shqipërisë

Gjatë muajit Janar 2019, niveli i përgjithshëm i depozitave arriti vlerën rreth 1.003.346 miliardë lekë. Krahasuar me një muaj më parë niveli i depozitave shënoi rritje prej rreth 14.699 milionë lekë, gjithashtu krahasuar me një vit më parë totali i depozitave ka shënuar rritje me 1.655 milionë lekë.


Sektori Fiskal

1. Buxheti i Konsoliduar

Për muajin Janar 2019 janë mbledhur rreth 34.532 miliardë lekë të ardhura, përkundrejt shpenzimeve të përgjithshme prej 32.422 miliardë lekë, ku pjesa më e madhe përfshin 28.971 miliardë lekë në shpenzime korrente dhe rreth 3.451 miliardë lekë në shpenzime kapitale, nga të cilat rreth 25% janë financime të huaja.

Nga të ardhurat gjithsej, pjesa e të ardhurave të mbledhura nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve dhe Doganave është rreth 22.638 miliardë lekë (ose rreth 100% e planit të periudhës). Të ardhurat e mbledhura nga pushteti vendor rreth 1.353 miliardë lekë (ose rreth 97% e planit të periudhës). Kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore 8.982 miliardë lekë (ose rreth 97% e planit të periudhës) dhe të ardhurat jokatimore në nivelin 1.258 miliardë lekë (ose rreth 62% e planit për muajin Janar 2019).

Nga totali i shpenzimeve korrente prej 28.971 miliardë lekë, 5.949 miliardë lekë (21% e totalit të shpenzimeve korrente) është shpenzuar për personelin, rreth 4.047 miliardë



lekë (14%) për shpenzime interesi, 2.487 miliardë leke (9%) për shpenzime operative dhe mirëmbajtje, 74 milionë lekë (0.3%) për subvencione, 11.923 miliardë lekë (41%) për shpenzimet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore dhe 2.701 miliardë lekë (9%) për shpenzimet e qeverisjes vendore, 1.327 miliardë lekë (5%) për shpenzimet e tjera. Këto përfaqësojnë 7% (shpenzime personeli), 10% (shpenzime për interesat), 5% (shpenzime operative dhe të mirëmbajtjes), 7% (subvencione), 6% (sigurimet shoqërore dhe shëndetësore), 5% (për shpenzimet e qeverisjes vendore) dhe 6% (shpenzimet e tjera) përkundrejt planifikimit të tyre vjetor.

Shpenzimet kapitale me financim të brendshëm për këtë periudhë ishin 5%, ndërsa financimi i huaj është 3% e planifikimit të tyre vjetor.

2. Të ardhurat sipas burimeve

Të ardhurat gjithsej të realizuara për muajin Janar 2019 ishin rreth 34.532 miliardë lekë, nga të cilat të ardhurat tatimore rreth 33.030 miliardë lekë, të ardhurat jo-tatimore në rreth 1.258 miliardë lekë.

Tab - 2	Të ardhurat gjatë muajit Janar 2019 (mld Lekë) Revenues during January 2019 (in billion ALL)			
	Burimi (Source)	Janar '19 January '19	Janar '18 January '18	Ndrysh(%) Chang (%)
	TVSH (VAT)	10.9	11.1	3.7
	Taksa doganore (Custom Tax)	0.4	0.4	-1.9
	Akcizat (Excise)	2.9	3.0	-4.7
	Tatimi mbi fitimin (Profit Tax)	1.6	1.4	13.3
	Tatim mbi të ardhurat personale (TAP) / (Income Tax)	3.6	3.4	7.0
	Taksat nacionale (National Tax)	2.8	3.1	-9.3

Burimi: Ministria e Financave, Statistikat Fiskale: Janar – 2019

Source: Ministry of Finance, Fiscal Statistics: January – 2019

3. Financimi i Bilancit Fiskal

Deficiti prej 2.1 miliardë lekë gjatë periudhës Janar 2019, u financua kryesisht nga huamarrja e brendshme, si mjeti kryesor i financimit të brendshëm dhe nga huaja afatgjatë e huaj.

Për muajin Janar 2019, disa nga treguesit kryesor fiskalë ishin:

- Realizimi i të ardhurave në masën 34.532 miliardë lekë,

- Realizimi i shpenzimeve në masën 32.422 miliardë lekë.

Në realizimin e të ardhurave për muajin Janar 2019, kontributin kryesor e kanë dhënë të ardhurat e mbledhura nga tatimet, të cilat arrijnë shifrën e 33.0 miliardë lekë. Në realizimin e shpenzimeve për këtë periudhë, peshën me të lartë e zënë shpenzimet korrente me 28.9 miliardë lekë dhe shpenzimet kapitale me rreth 3.4 miliardë lekë.

Aneksi Statistikor

Tab - 1

Muaji	Mujor (Monthly)					Mesatar Mujor (Monthly Average)					Vjetor (Annual)					Month
	2015	2016	2017	2018	2019	2015	2016	2017	2018	2019	2015	2016	2017	2018	2019	
Janar	1.4	0.9	1.5	1.5	1.6	1.4	0.9	1.5	1.5	1.6	1.3	1.5	2.8	1.7	1.9	January
Shkurt	2.4	1.1	0.5	0.8		1.9	1.0	1.0	1.0		2.3	0.2	2.2	2.1		February
Mars	0.4	0.5	0.4	0.3		1.4	0.8	0.8	0.9		2.2	0.3	2.1	2.0		March
Prill	-0.5	-0.4	-0.6	-0.5		0.9	0.5	0.5	0.8		2.3	0.3	1.9	2.1		April
Maj	-1.6	-1.2	-1.2	-1.2		0.3	0.2	0.1	0.2		1.8	0.7	2.0	2.1		May
Qershor	-1.1	-0.6	-0.4	-0.1		0.1	0.04	0.0	0.1		1.4	1.2	2.2	2.4		June
Korrik	-0.7	0.05	-0.14	-0.27		0.1	0.21	0.0	0.1		1.3	1.9	2.0	2.3		July
Gusht	0.8	0.86	0.41	0.36		0.1	0.23	0.1	0.1		1.9	2.0	1.6	2.2		August
Shtator	0.6	0.40	0.36	0.23		0.2	0.17	0.1	0.1		2.2	1.8	1.6	2.1		September
Tetor	0.01	-0.2	0.0	-0.2		0.2	0.13	0.1	0.1		2.1	1.5	1.9	1.9		October
Nëntor	-0.3	0.1	-0.1	-0.2		0.1	0.12	0.1	0.1		2.1	1.9	1.7	1.8		November
Dhjetor	0.6	0.9	1.0	1.1		0.17	0.19	0.2	0.2		2.0	2.2	1.8	1.8		December

Burimi: INSTAT

Source: INSTAT

Tab - 2

Kursi i këmbimit

Exchange rate

Monedha	2015	2016	2017	2018	2019		Currency
					Janar		
					January		
<i>Mesatarja e periudhës</i>							<i>Average of period</i>
USD	126.64	128.29	112.56	108.43	108.92		USD
EURO	137.65	135.27	133.25	123.45	124.39		EURO
<i>Fundi i periudhës</i>							<i>In the end of period</i>
USD	125.79	128.17	111.10	107.82	108.58		USD
EURO	137.28	135.23	132.95	123.42	124.64		EURO

Burimi : Banka e Shqipërisë

Source : Bank of Albania

Tab - 3

Normat e interesit me bazë vjetore (në Lek)

Annual Interest Rates (in ALL)

	2015	2016	2017	2018	2019	
Në përqindje					Janar	In percent
					January	
Norma e depozitave						Deposits rates
12-M	1.27	0.78	0.80	0.75	0.73	12-M
6-M	1.17	0.78	0.56	0.56	0.45	6-M
3-M	0.54	0.27	0.29	0.30	0.24	3-M
1-M	0.88	0.87	0.82	0.62	0.65	1-M
Norma e huasë						Lending rates
12-M	7.47	4.54	6.79	6.34	6.76	12-M
6-M	8.35	7.01	8.12	8.16	7.63	6-M
Norma e letrave me vlerë						Securities rates
Bono thesari 1/						Treasury bills 1/
3-M	-	-	-	-	-	3-M
6-M	2.46	2.00	-	-	-	6-M
12-M	2.40	2.92	2.63	1.43	1.33	12-M

Burimi : Banka e Shqipërisë

Source : Bank of Albania

TREGUESIT FISKAL SIPAS BUXHETIT TË KONSOLIDUAR 2019

Fiscal indicators regarding consolidated budget of 2019

Të dhëna progresive (Progressive Data)

në milionë Lekë (in million ALL)

Nr.	E M Ë R T I M I	Janar January	ITEMS
	TOTALI TË ARDHURAVE	34,532	TOTAL REVENUE
I.	Të ardhura nga ndihmat	244	Grands
II.	Të ardhura tatimore	33,030	Tax Revenue
II.1	Nga Tatimet dhe Doganat	22,638	From tax offices and customs
1	Tatimi mbi Vlerën e Shtuar	10,971	V.A. T
2	Tatimi mbi Fitimin	1,613	Profit Tax
3	Akcizat	2,900	Excise Tax
4	Tatimi mbi të Ardhurat Personale	3,677	Personal Income Tax
5	Taksa Nacionale dhe të tjera	3,068	National Taxes and others
6	Taksa Doganore	410	Customs Duties
II.2	Të ardhura nga Pushteti Vendor	1,353	Revenues from Local Gov.
1	Taksë mbi Pasurinë (ndërtesat)	221	Property Tax
2	Taksë mbi Biznesin e vogël	1	Small Business Tax
3	Taksa Lokale	1,131	Local Taxes
II.3	Të ardh nga fondet speciale	9,038	Social ins. contributions
1	Sigurimi Shoqëror	7,711	Social Insurance
2	Sigurimi Shëndetsor	1,271	Health insurance
III.	Të ardhura Jotatimore	1,258	Nontax Revenue
1	Tran.Fitimi nga Banka e Shqipërisë		Profit transfer from BOA
2	Të ardhura nga Inst.Buxhetore	712	Income of budgetary institutions
	TOTALI I SHPENZIMEVE	32,422	TOTAL EXPENDITURE
I.	Shpenzime Korrente	28,971	Current Expenditures
I.1	Personeli	5,949	Personnel expenditures
1	Paga	5,100	Wages
2	Kontributi për Sigurime Shoqërore	844	Social insurance contributions
I.2	Interesat	4,047	Interest
1	Të Brendshme	2,846	Domestic
2	Të Huaja	1,200	Foreign
I.3	Shpenzime Operative Mirëmbajtje	2,487	Operational & Maintenance
I.4	Subveconet	74	Subsidies
I.5	Shpenzime për fonde speciale	12,387	Social insurance outlays
1	Sigurime Shoqërore	9,547	Social insurance
2	Sigurime Shëndetsore	2,376	Health insurance
I.6	Shpenzime per Buxhetin Vendor	2,701	Local budget expenditure
I.7	Shpenzime të tjera	1,327	Other expenditures
1	Pagesa e Papunesisë	33	Unemployment insurance benefits
II	Fondi Rezerve, Kontigjenca	0	Reserve fund/contingency
III	Shpenzime Kapitale	3,451	Capital expenditures
1	Financimi Brendshëm	2,583	Domestically financing
2	Financimi Huaj	863	Foreign financed
IV	Detyrimet e prapambetuara		Arrears
V.	DEFICITI	2,110	CASH BALANCE
V.1	FINANCIMI DEFICITIT	-2,110	CASH BALANCE FINANCING
V.2	Brendshëm	-1,502	Domestic
1	Të ardhura nga privatizimi	23	Privatization receipts
2	Hua-marrje e brendshme	-5,900	Domestic new borrowing (net)
3	Të tjera	4,375	Others
V.3	I huaj	-608	Foreign
1	Hua afatgjatë(e marrë)	1,403	Long-term foreign borrowing (gross)
2	Nga e cila nënhua	98	Subsidiary Loan
3	Ndryshimi i gjendjes së arkës*	-684	Chang. of stat. Account
4	Ripagesat	-1,327	Repayments
5	Mbështetje Buxhetore	-	Budgetary Support

Burimi : Ministria e Financave

Source : Ministry of Finance

* "Ndryshimi i gjendjes së arkës" përfaqëson ndryshimin e Depozitës së Financimeve të Huaja

Tabela e investimeve 2019

Table of investments 2019

Të dhëna progresive (Progressive Data) në milionë Lekë (in million ALL)

		Janar	
		January	
Financim i brendshëm	-	1,502	Domestic financing
Në %		71.2	In %
Financim i huaj	-	608	Foreign financing
Në %		28.8	In %
Totali		-2,110	Total
Në %		100	In %

Burimi: Ministria e Financave

Source: Ministry of Finance

**Tab - 6 TË ARDHURAT DOGANORE 2019
CUSTOMS REVENUES 2019**

Të dhëna progresive (Progressive Data)

në milionë Lekë (in million Lek)

	Janar	
	January	
Taksë doganore	410	Customs Duties
TVSH	6,893	V.A.T
Akcizë	2,900	Excises
Të tjera (Renta Minerare)	201	Others (Mineral Rent)
TOTALI	10,404	Total

TË ARDHURAT TATIMORE 2019 (TAX REVENUE)

TVSH	4,079	V.A.T
Tatim mbi fitimin	1,613	Profit Tax
Tatimi mbi të ardhurat personale	3,677	Personal income tax
Taksa nacionale dhe të tjera	2,867	National taxes
TOTALI	12,235	Total
TOTALI I PËRGJITHSHËM	22,639	OVERALL TOTAL

Burimi: Ministria e Financave

Source: Ministry of Finance

DEFICITI DHE FINANCIMI PËR 2019

The Deficit and Its Financing for 2019

Të dhëna progresive (Progressive Data)

Në milionë lekë (In million Leks)

	Janar January	
TË ARDHURAT	34,532	REVENUE
SHPENZIMET	32,422	EXPENDITURES
BILANCI FISKAL	2,110	FISCAL BALANCE
FINANCIMI I BILANCIT FISKAL	-2,110	FINANCING
Financimi i brendshëm	-1,502	Domestic
a. Bono Thesari Neto	-1,799	Treasury bills
b. Obligacione	-4,088	Bonds
c. <i>Ndryshimi i gjëndjes së arkës</i>	13,883	Chang.of stat. account
Depozita e qeverisë në BSH	13,689	Deposit of Government in B.O.A
Depozita e ISSH dhe ISKSH	193	Deposit of Social & Health Ins.
d.Mjete në ruajtje	418	Non-budget revenues
e.Të ardhura nga privatizimi	23	Privatization receipts
f.Të tjera detyrime	-9,926	Others
g.Huamarrje Brendshme Vendori	-14	Local Borrowing
Financimi i jashtëm	-608	Foreing
a. Hua afatgjatë	1,403	Long-term foreign borrowing (gross)
b. Ndryshimi I gjëndjes së arkës	-684	Chang. of stat. Account
c.Ripagesat	-1,327	Repayments
d.Mbeshtetje Buxhetore	0	Budgetary Support

Burimi: Ministria e Financave

Source: Ministry of Finance

BILANCI I PAGESAVE

Balance of payments

Në milion Euro

In millions Euro

	Viti 2013	Viti 2014	Viti 2015	Viti 2016	Viti 2017	3M_I_2018	3M_II_2018	3M_III_2018	
Llogaria korentë	-1,026.70	-1,303.20	-1,160.50	-1,029.70	-803.10	-170.50	-176.30	-146.50	Current Account.
Bilanci tregtar	-1,729.30	-2,136.60	-2,298.80	-2,602.80	-2,823.80	-614.60	-684.30	-740.60	Trade Balance.
Eksporti I mallrave fob	1,731.50	925.30	771.10	713.70	797.20	218.40	277.80	234.90	Merchandise Exports. Fob
Importi I mallrave fob	-3,460.80	-3,061.90	-3,069.90	-3,316.50	-3,621.00	-833.00	-962.10	-975.50	Merchandise Imports. Fob
Bilanci i shërbimeve	8.90	268.40	502.80	796.60	1,082.20	254.60	255.40	379.90	Services Balance.
Shërbimet Kredi	1,655.00	2,031.50	2,028.20	2,395.70	2,855.90	621.70	744.30	1,004.00	Services Credit
Shërbimet Debi	-1,646.10	1,763.10	1,503.30	1,599.10	1,773.70	367.10	488.90	624.10	Services Debt
Bilanci i të ardhurave	-8.40	-159.60	-133.00	-44.10	90.70	-13.30	13.70	-18.50	Balance of Incomes
Të ardhurat Kredi	193.30	110.60	126.00	177.10	405.40	73.50	125.40	96.10	Income Credit
Të ardhurat Debi	-201.70	-270.20	-259.00	-221.20	-314.70	-86.80	-111.70	-114.60	Income Debt
Bilanci i transfertave	702.10	724.60	768.50	820.60	847.80	202.80	238.90	232.70	Balance of Transfers
Transferta private	681.40	851.80	921.50	961.20	961.90	224.40	260.50	253.90	Private Unrequired Transfers
Transferrat shtetërore	20.70	-127.20	-153.00	-140.60	-114.10	-21.60	-21.60	-21.20	Official Unrequired Transfers
Llogaria kapitale	47.70	86.70	125.70	66.30	122.40	18.30	21.20	22.90	Capital Account
Llogaria financiare	775.60	-956.30	-1,326.20	-712.60	-1,096.70	-146.40	-285.20	-165.70	Financial Account
Investime direkte	893.10	-801.30	-823.00	-958.40	-972.60	-291.90	-222.60	-268.50	Direct Investment
Investime portofoli	-103.70	120.80	-324.80	204.60	-101.50	3.50	110.60	13.30	Portfolio Investment
Kapitale të tjera	-13.80	-275.80	-88.50	181.60	47.90	141.40	-173.30	89.00	Other Capital
Gabime dhe harresa neto	315.30	311.00	296.00	298.80	-230.10	-135.50	-45.00	112.40	Net errors and omissions
Bilanci i përgjithshëm	111.90	50.80	259.50	48.00	185.90	-141.30	85.10	154.50	Overall Balance
		0.00	0.00		0.00				
Rezervat	-104.40	97.20	609.60	47.60	185.40	-142.40	85.10	154.80	Reserve Assets
Përdor kred & huash nga FMN	-7.80	46.40	89.90	140.40	70.50	-0.60	-0.10	-0.50	Use of Fund Credit and Loans

Burimi : Banka e Shqipërisë

Source : Bank of Albania

MJETET VALUTORE NETO

Net Foreign Assets

Në milionë Lekë Fundit i periudhës	2015	2016	2017	2018	2019	Millions of Lek End of Period
					Janar January	
Mjetet valutore neto	365,663.3	389,612.7	390,687.6	412,444.5	404,157.2	Net Foreign assets
Predendime ndaj jorezidentëve	407,654.7	418,562.1	417,605.4	436,487.8	428,969.2	Claims on non-residents
Minus: Detyrime ndaj jorezidentëve	41,991.5	28,949.4	26,917.8	24,043.3	24,812.0	Minus: Liabilities to non-residents
Mjetet e brendshme	63,394	65,915.7	59,998	21,779	24,331	Domestic Assets
Pretendimet neto ndaj qeverisë qendrore	48,752	34,255.6	18,407	-12,366	277	Claims on Central Government
Pretendimet ndaj qeverisë qendrore	75,143.9	53,279.9	52,839.5	55,628.9	56,113.1	Net Claims on Central Government
Minus: Detyrime ndaj qeverisë qendrore	26,391.9	19,024.3	34,432.8	67,994.8	55,836.4	Minus: Due to Central Government
Pretendime ndaj korporatave të tjera depozituese	12,237.0	29,934.4	39,871.3	32,317.6	22,207.0	Claims on other depository corporations
Pretendime ndaj korporatave të tjera financiare	-	-	-	-	0	Claims on other financial corporations
Pretendime ndaj korporatave jofinanciare publike	-	-	-	-	0	Claims on public non-financial corporations
Pretendime ndaj korporatave të tjera jofinanciare	-	-	-	-	0	Claims on other non-financial corporations
Pretendime ndaj sektorëve të tjerë rezidentë	1,648.9	1,725.7	1,720.0	1,827.2	1,847.0	Claims on other resident sectors
Baza Monetare	383,972.8	414,380.9	452,243.1	423,427.9	413,895.1	Monetary Base
Depozita të papërfshira në paranë e gjerë	451.8	194.0	146.6	80.6	81.3	Deposits not included in broad money
Huatë	-	-	-	-	0	Loans
Llogari të pagueshme	34.2	47.2	96.8	285.4	246.0	Other accounts payable
Të tjera neto	-18,792	-20,953.6	-20,683	-20,659	-20,670	Other items net
Aksione	63,391.1	61,859.9	45,882.2	31,088.6	34,935.9	Shares and other equity

Burimi : Banka e Shqipërisë

Source : Bank of Albania

Tab - 10 KREDIA PËR EKONOMINË
Credit to Economy

Në milion Lekë Fundi i periudhës	2015	2016	2017	2018	2019		Million of Lek End of Period
					Janar January		
Totali i kredisë	546,873	547,602.4	550,280.4	532,628.2	536,695.9		Total Credit
Kredia për qeverinë lokale	887.7	845.5	787.7	539.0	677.1		Credits to local Government
Në Lekë	887.7	845.5	787.7	539.0	677.1		in Lek
Në valutë	-	-	0.0	0.0	-		in Foreign Currency
Kredia për korporatat jofinanciare publike	27,419.7	26,863.9	29,515.4	20,270.1	20,810.7		Credits to Public Non-financial Corporations
Në Lekë	22,326.1	23,993.9	24,453.5	16,594.2	16,799.0		in Lek
Në valutë	5,093.6	2,870.0	5,061.9	3,675.9	4,011.7		in Foreign Currency
Kredia për korporatat jofinanciare private	355,725.2	343,483.0	334,762.9	317,722.0	320,223.3		Credits to other Non-financial Corporations
Në Lekë	129,233.7	131,743.5	136,075.7	127,999.7	127,162.2		in Lek
Në valutë	226,491.5	211,739.5	198,687.2	189,722.3	193,061.1		in Foreign Currency
Kredia për korporatat e tjera financiare	9,537.7	8,687.6	7,944.6	10,164.0	10,234.3		Credits to Other Financial Corporations
Në Lekë	5,036.2	4,242.3	3,522.3	4,802.1	4,738.4		in Lek
Në valute	4,501.5	4,445.3	4,422.3	5,361.9	5,495.9		in Foreign Currency
Pretendime për sektorë të tjerë rezidentë	153,303.1	167,722.4	177,269.8	183,933.1	184,750.5		Claims to other Resident Sectors
Në Lekë	83,319.7	98,722.3	108,419.1	118,744.1	119,297.6		in Lek
Në valutë	69,983.4	69,000.1	68,850.7	65,189.0	65,452.9		in Foreign Currency

Burimi : Banka e Shqipërisë

Source : Bank of Albania

Tab - 11 **OFERTA E PARASË**
Money Supply

Mujor-Monthly

Në milion Lekë Fundi i periudhës	2015	2016	2017	2018	2019		Millions of LEK End of Period
					Janar	January	
Baza monetare	383,972.8	414,380.9	425,243.1	423,427.9	413,895.1		Base Money
Ndryshimi vjetor në %	15.3	1.1	1.0	1.0	1.0		Y/Y change in %
Paraja jashtë korporatave depozituese	239,218.1	249,256.5	265,156.0	275,281.4	271,542.9		Currency Outside Depository
Ndryshimi vjetor në %	9.9	4.2	6.4	3.8	5.5		Y/Y change in %
Depozita	687,292.6	737,808	741,157	745,304	755,851.1		Deposits
Ndryshimi vjetor në %	-29.7	7.3	0.5	0.6	2.0		Y/Y change in %
Agregati M1	384,106.9	435,432.3	461,550.1	478,717.6	481,254.7		M1 Aggregate
Ndryshimi vjetor në %	8.7	13.4	6.0	3.7	6.5		Y/Y change in %
Agregati M2	723,975.7	736,944.1	738,900.0	731,352.3	732,038.2		M2 Aggregate
Ndryshimi vjetor në %	0.2	1.9	0.3	-1.0	0.9		Y/Y change in %
Agregati M3	1,218,101.2	1,263,453.8	1,266,906.9	1,263,928.1	1,274,889.0		M3 Aggregate
Ndryshimi vjetor në %	1.9	3.9	0.3	-0.2	1.3		Y/Y change in %
Burimet e bazës monetare							Monetary Base sources
Mjetet e huaja neto	365,663.3	389,612.7	390,687.6	412,444.5	404,157.2		Net foreign assets
Mjetet e brendshme neto	63,394.2	65,915.7	59,998.0	21,779.0	24,330.7		Domestic assets
Pretendimet ndaj qeverisë qendrore neto	48,752.0	34,255.6	18,406.7	-12,365.8	276.7		Net Claims on central government
Pretendimet ndaj korporatave të tjera depozituese	12,987.1	29,934.4	39,871.3	32,317.6	22,207.0		Claims on other depository corporations

Burimi : Banka e Shqipërisë

Source : Bank of Albania

DEPOZITAT

Deposits

Mujor-Monthly

Në milionë Lekë Fundi i periudhës	2015	2016	2017	2018	2019	Millions of Leks End of Period
					Janar January	
Në lekë	493,374	487,687	473,744	456,071	460,495	In national currency
Depozitat e transfer + D. me likuiditet të lartë	153,506	186,176	196,394	203,436	209,712	Transferable deposits+Liquid deposits
Qeveria lokale	1,473.8	1,907.5	1,344.4	1,482.1	1,294.7	Local governments
Korporata jofinanciare publike	8,736.2	6,786.0	8,656.7	8,861.1	9,710.2	Public non-financial corporations
Korporata të tjera financiare	1,258.9	2,071.0	2,524.8	2,586.8	3,014.7	Other financial corporations
Korporata të tjera jofinanciare	40,993.6	46,051.0	48,979.3	49,221.4	53,372.8	Other non-financial corporations
Sektorë të tjerë rezidentë	101,043.0	129,360.4	134,889.0	141,284.9	142,319.5	Other resident sectors
Depozita të tjera	339,869	301,512	277,350	252,635	250,783	Other deposits
Qeveria lokale	29.9	18.9	15.2	13.1	12.8	Local governments
Korporata jofinanciare publike	815.0	976.8	705.2	1,634.7	1,707.0	Public non-financial corporations
Korporata të tjera financiare	3,573.4	7,553.4	9,282.1	5,050.5	4,126.7	Other financial corporations
Korporata të tjera jofinanciare	11,292.1	6,502.2	9,062.4	9,687.0	9,171.0	Other non-financial corporations
Sektorë të tjerë rezidentë	324,158.3	286,460.2	258,285.1	236,249.4	235,765.9	Other resident sectors
Në valutë	193,918	250,121	267,413	289,233	295,356	In foreign currency
Qeveria lokale	209.5	366.1	139.8	113.4	147.7	Local governments
Korporata jofinanciare publike	3,645.4	2,999.4	2,086.3	1,407.7	1,711.8	Public non-financial corporations
Korporata të tjera financiare	2,641.2	1,815.4	3,756.9	3,616.6	3,561.2	Other financial corporations
Korporata të tjera jofinanciare	53,618.9	73,325.0	74,187.3	78,055.3	81,182.5	Other non-financial corporations
Sektorë të tjerë rezidentë	133,803.4	171,614.8	187,242.7	206,039.8	208,752.6	Other resident sectors
Totali	687,293	737,808	741,157	745,304	755,851	Total
Qeveria lokale	1,713.2	2,292.5	1,499.4	1,608.6	1,455.2	Local governments
Korporata jofinanciare publike	13,196.6	10,762.2	11,448.2	11,903.5	13,129.0	Public non-financial corporations
Korporata të tjera financiare	7,473.5	11,439.8	15,563.8	11,253.9	10,702.6	Other financial corporations
Korporata të tjera jofinanciare	105,904.6	125,878.2	132,229.0	136,963.7	143,726.3	Other non-financial corporations
Sektorë të tjerë rezidentë	559,004.7	587,435.4	580,416.8	583,574.1	586,838.0	Other resident sectors

BILANCI I PËRMBLEDHUR I BSH

Consolidated BoA Balance sheet

Në milion Lekë Fundi i periudhës	2015	2016	2017	2018	2019		Millions of Lek End of period
					Janar January		
AKTIVET	516,358	524,731	532,927	547,104	529,941		
Total	126,386	131,887	187,367	209,596	197,631		Total
Mbajtjet e SDR	30,578.8	27,211.8	25,725.3	19,625.0	20,028.7		SDR holdings
Arka në valutë	84.9	52.0	24.3	67.1	18.7		Foreign currency
Depozitat	95,722.4	104,622.9	161,617.3	189,904.2	177,584.0		Deposits
Letrat me vlerë të ndryshme nga aksionet	323,679	315,113	259,538	261,577	266,052		Securities other than shares
Jorezident	270,453.6	261,877.5	206,818.9	205,990.4	209,990.6		nonresidents
Qeveria qendrore	53,225.5	53,235.2	52,718.8	55,586.8	56,061.0		central government
Huatë	14,641	31,660	41,591	34,145	24,054		Loans
Qeveria qendrore	-	-	-	-	-		Central Government
Korporata të tjera depozituese	12,987.1	29,934.4	39,871.3	32,317.6	22,207.0		Other depository corporations
Sektorë të tjerë rezidentë	1,654.0	1,725.9	1,719.8	1,827.1	1,846.5		Other resident secotrs
Derivatet financiare	27.7	15.8	11.7	19.3	43.6		Financial derivatives
Llogari të arketueshme	32,741.6	25,094.1	23,844.9	21,224.9	21,648.6		Receivable accounts
Mjetet jofinanciare	18,882.5	20,961.2	20,574.7	20,542.0	20,512.4		Nonfinancial assets
DETYRIMET	516,358	524,731	532,927	547,104	529,941		LIABILITIES
Total	241,006	262,031	278,611	286,209	282,051		Total
Para në qarkullim	239,218.1	258,848.0	274,711.8	286,158.4	281,990.3		Currency in Circulation
Depozitat e përfshira në paranë e gjerë	1,787.9	3,183.2	3,899.2	50.6	61.1		Deposits included in broad money
Depozita të papërfshira në paranë e gjerë	201,586	191,380	200,514	222,292	204,765		Deposits excluded from broad money
Jorezident	31,826.2	19,860.9	19,350.9	17,047.3	17,053.6		Nonresidents
Qeveria qendrore	26,340.8	18,975.1	34,384.3	67,945.2	55,786.6		Central government
Korporata të tjera depozituese	142,966.8	152,349.7	146,632.1	137,218.8	131,843.7		Other depository corporations
Korporata të tjera jofinanciare	87.4	72.1	66.7	49.6	50.3		Other nonfinancial corporations
Sektorë të tjerë rezidentë	364.4	121.9	79.9	31.0	31.0		
Huatë	1,810	314	116	18	0		-
Jorezidentët	1,809.6	314.2	115.6	18.3	0.1		Nonresidents
Qeveria qendrore	-	-	-	-	-		Central Government
Korporata të tjera depozituese	-	-	-	-	-		Other depository corporations
Llogari të pagueshme	461.1	1,164.6	463.8	518.7	1,122.0		Other accounts payable
Alokimi i SDR	8,104.4	7,981.2	7,340.5	6,977.7	7,066.3		SDR allocation
Aksione dhe instrumenta të tjerë	63,391.1	61,859.9	45,882.2	31,088.6	34,935.9		Shares and other equity

Burimi : Banka e Shqipërisë

Source : Bank of Albania